



Human Rights Review Panel

Buletini informativ nr. 14, 1 gusht - 31 tetor 2016

- Seanca e fundit e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut
- Takime me Shërbimin Evropian për Veprim të Jashtëm dhe Komitetin për Aspekte Civile të Menaxhimit të Krizave, Bruksel.
- Takim me shefin e Misionit të EULEX-it në Kosovë
- Takim me përfaqësuesen speciale të Bashkimit Evropian në Kosovë
- Burimet njerëzore
- Statistikat e lëndëve
- Seanca e radhës

Seancat e fundit të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

Seanca e fundit e Panelit është mbajtur nga data 17 tetor deri me 19 tetor 2016.

Paneli ka nxjerrë tre (3) vendime lidhur me meritat dhe ka konstatuar nëntë (9) shkelje të të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it Kosovë si në vijim:

Lëndët nr. 2014-11 deri në 2014-17, D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinovic, H.S. dhe I.R., kundër EULEX-it; Lënda nr. 2014-34, Rejhane Sadiku-Syla kundër EULEX-it dhe lënda nr. 2014-37, Y.B. kundër EULEX-it.

Paneli gjithashtu ka nxjerrë një (1) vendim pasues rreth zbatimit të rekomandimeve të tij nga ana e shefes së Misionit në lëndën nr. 2014-32 L.O. kundër EULEX-it.

Lëndët nr. 2014-11 deri në 2014-17, D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinovic, H.S. dhe I.R. kundër EULEX-it.

Shtatë (7) ankesa në këto lëndë [2014-11 deri në 2014-17, D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinovic, H.S. dhe I.R. kundër EULEX-it](#) kanë të bëjnë me vrasjen, dhe në disa raste me zhdukjet, e personave të përkatësisë etnike serbe që kanë ndodhur në Kosovë mes 16 qershorit 1999 dhe 11 marsit 2000. Ankuesit janë përfaqësuar nga znj. Jovanka Stojavljevic-Savic, *Savic & Co Solicitors, 39 Warren Street, Londër, W1T 6AF.*

Duke pasur parasysh natyrën e shtatë ankuesve, të cilët janë të përkatësisë etnike serbe, si dhe ngjashmëritë e konsiderueshme që ekzistojnë mes çështjeve të ngritura në ankesa, Paneli ka vendosur të urdhërojë bashkimin formal të lëndëve në përputhje me rregullën 20 të rregullores së punës (ReP).

Në shqyrtimin e ligjit të zbatueshëm në këto lëndë, Paneli ka marrë parasysh bazën e autorizimit të prokurorëve të EULEX-it Kosovë për të hetuar në rrethana të jashtëzakonshme siç saktësohen në nenin 7A të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që kanë të bëjnë me mandatin e misionit për sundimin e ligjit të Bashkimit Evropian, Misioni në Republikën e Kosovës (i datës 13 mars 2008). Kjo dispozitë përcakton se:

“Në rrethana të jashtëzakonshme lënda i caktohet një prokurori të EULEX-it me një vendim të përbashkët të kryeprokurorit të shtetit dhe autoritetet kompetent të EULEX-it Kosovë”.

Paneli ka konstatuar se faktorët e mëposhtëm, ndër të tjera, do të zbatohen në vlerësimin e fakteve përkatëse në përcaktimin e asaj që kanë përbërë “rrethanat e jashtëzakonshme”, duke e arsyetuar marrjen përsipër të lëndës nga prokurori i EULEX-it:

Së pari, Paneli duhet të marrë parasysh nëse ndonjë hetim efektiv i pretendimeve të privimit të jetës është bërë para se lënda të sillej në vëmendjen e EULEX-it. Nëse nuk është ashtu, kjo ka shkuar në favor të prokurorëve të EULEX-it që ushtrojnë kompetencat e tyre “të jashtëzakonshme” që ta merr përsipër lëndën. Paneli ka konstatuar se këto lëndë nuk kanë qenë objekt i ndonjë hetimi të plotë dhe efektiv nga ndonjë organ gjatë ndonjë periudhe të konsiderueshme kohore.

Së dyti, duhet të shqyrtohet nëse çështjet rreth të cilave ka pasur ankesa kanë të bëjnë me të drejtat e rëndësishme dhe se shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut janë të një rëndësie të madhe. Këto faktorë prapë do të peshonin në favor të përfshirjes së “jashtëzakonshme” të prokurorëve të EULEX-it. Të gjitha këto lëndë nën shqyrtim e sipër kanë të bëjnë me të drejtat themelore, përfshirë të drejtën për jetë.

Gjithashtu, Paneli ishte i bindur se ka pasur një mundësi të madhe që faktet rreth të cilave ka pasur ankesa sikurse për vrasjen dhe zhdukjen e viktimave kishin të bënin me faktorë ndër-etnikë dhe/ose fetarë. Ky fakt po ashtu ka shkuar në favor të EULEX-it Kosovë që ushtron kompetencat e veta juridiksionale në kuadër të mandatit të tij ekzekutiv.

Paneli ka theksuar se lëndët e tilla duhet të jenë prioritete të qarta hetimore në një mjedis pas konfliktit, ku marrëdhëniet ndër-etnike dhe fetare mund të jenë të tensionuara dhe të brishta. Paneli ka konkluduar se ky faktor nuk duket se ishte marrë parasysh nga EULEX-it në përcaktimin nëse ekzistonin apo jo “rrethanat e jashtëzakonshme” në lidhje me lëndët.

Së treti, në qoftë se prokurorët e EULEX-it vendosin që mos të ushtrojnë kompetencat e tyre “të jashtëzakonshme”, atëherë shtrohet pyetja nëse ka ndonjë mundësi reale dhe të mirëfilltë nga autoritetet e Kosovës që të kryejnë përgjegjësitë e tyre hetimore dhe prokuroriale. Nuk kishte asnjë tregues në këto raste se kjo ka ndodhur ose që veprimet e duhura janë marrë për t'i vërtetuar faktet përkatëse.

Prandaj Paneli ka rekomanduar që ndër të tjera shefi i Misionit (ShM) t'ju komunikojë vendimet të gjitha organet përkatëse hetimore dhe prokuroriale të EULEX-it Kosovë. Më tej Paneli ka rekomanduar që ShM duhet t'i udhëzojë organet hetimore dhe prokuroriale të EULEX-it mbi rëndësinë e hetimit të plotë të rasteve të të vrarëve dhe personave të zhdukur që nga koha e konfliktit të armatosur në Kosovë në vitin 1999 e tutje.

ShM po ashtu ishte ftuar që të tërheq vëmendjen e autoriteteve hetimore dhe prokuroriale brenda EULEX-it Kosovë drejt faktorëve të renditur në vendim si të rëndësishëm për vlerësimin e kompetencave “të jashtëzakonshme” të prokurorëve të EULEX-it në bazë të nenit 7(A) të Ligjit të rishikuar mbi Kompetencat dhe më tej që t’i udhëzoj ata mbi rëndësinë e marrjes parasysh të këtyre faktorëve në vlerësimin nëse ata duhet apo jo të marrin përgjegjësinë për hetimin e rasteve të tilla.

Paneli është plotësisht i vetëdijshëm rreth sfidave dhe vështirësive që kanë rezultuar nga rikonfigurimi i fundit i stafit në EULEX. Megjithatë brenda këtyre kufizimeve dhe në proporcion me rëndësinë që Misioni i jep mbrojtjes efektive të të drejtave të njeriut, Paneli ka ftuar ShM që të siguroj se organet hetimore brenda EULEX-it të jenë të pajisura me burime të nevojshme dhe mbështetje që është e nevojshme për të arritur misioni i tyre në mënyrë efektive dhe në përputhje me mbrojtjen procedurale të të drejtave të njeriut, në veçanti ato të drejta të cilat janë të garantuara me nenet 2 dhe 3 në Konventën Evropiane për të drejtat e njeriut (Konventa).

Në përfundim, Paneli ka konstatuar se përpjekjet hetimore të EULEX-it Kosovë ishin të pamjaftueshme në këto raste dhe se për këtë arsye kanë rezultuar me shkelje të të drejtave të ankuesve të garantuara me nenin 2, e drejta për jetën; nenin 3, ndalimi i torturës ose trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës, dhe nenin 13, e drejta për një mjet efektiv në lidhje me nenin 2 të Konventës.

Lënda nr. 2014-34, Rejhane Sadiku-Syla kundër EULEX-it.

Në këtë lëndë [2014-34, Rejhane Sadiku-Syla kundër EULEX-it](#), ankuesja znj. Rejhane Sadiku-Syla është përfaqësuar nga Kushtrim Istrefi, jurist, 12 Rue de l’ecole de medicine, 1205, Gjenevë, Zvicër.

Babai i ankesës, z. Sylë Sadiku ishte zhdukur nga vendbanimi i tij në veri të Mitrovicë, gjatë një sulmi nga një grup personash të armatosur që besohet se ishin të përkatësisë etnike serbe, me 7 dhjetor 2000. Sulmi ishte parë nga një motër e ankuseses, e cila më vonë ishte evakuuar nga trupat franceze të KFOR-it. Ankuesja nuk ka marrë asnjë informacion mbi vendndodhjen dhe fatin e babait të saj që prej zhdukjes së tij.

Ankuesja ka parashtuar se EULEX-i Kosovë i kishte shkelur të drejtat e saja të garantuara me nenet 2 dhe 3 të Konventës në bazë të pjesëve të tyre procedurale. Në veçanti është pohuar që prokurorët e EULEX-it kanë dështuar të nisnin një hetim në përputhje me ligjet e Kosovës dhe mandatin e EULEX-it, se EULEX-i kishte vonuar tepër procesin hetimor dhe se në referimin e rastit tek prokurorët e Kosovës, EULEX-i e ishte lënë pas dore seriozitetin e rasti, vendndodhjen gjeografike të krimit (Mitrovica veriore), karakterin e krimit të luftës së rastit dhe faktin që incidenti me shumë gjasa ishte i motivuar nga urrejtja etnike.

Ndër të tjera, nga natyra ndëretnike dhe aspekti i zhdukjes i lëndës, Paneli ka përsëritur qëndrimin e tij lidhur me “rrethanat e jashtëzakonshme” brenda kuptimit të nenit 7 A të ligjit të përmendur më lartë, të ligjit të njëjtë që ishte shqyrtuar në kontekstin e lëndës Veselinovic dhe të tjerët, siç është përmbledhur më sipër.

Duke pasur parasysh rrethanat e çështjes në tërësinë e tyre, Paneli ka konstatuar se përpjekjet hetimore të EULEX-it Kosovë në lidhje me zhdukjen e babait të ankuseses, ishin të pamjaftueshme dhe në këtë mënyrë ka rezultuar në shkelje të të drejtave të ankuseses siç garantohet me nenet 2 dhe 3 të Konventës në lidhje me të drejtën për jetën dhe ndalimin e torturës në pjesët procedurale të tyre, dhe me nenin 13, e drejta për zgjidhje efektive, në lidhje me nenin 2 të Konventës. Duke pasur parasysh këto gjetje, Paneli konsideron se ishte e panevojshme që të shqyrtohej rasti sipas nenit 8 të Konventës.

Lënda nr. 2014-37, Y.B. kundër EULEX-it

Me 4 korrik 2014, një prokuror i EULEX-it në Zyrën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK) ka ngritur aktakuzë ndaj N.K. në Gjykatën Themelore, Prishtinë, në të cilën ai ishte akuzuar për krim të organizuar, vrasje të rëndë dhe kundërvajtje të ndryshme për drogë.

Emri i ankuesit ishte paraqitur në aktakuzë. Në veçanti, aty deklarohet se N.K. "në bashkëkryerje" me ankuesin dhe disa persona të tjerë "ka organizuar, themeluar, mbikëqyrur, udhëhequr dhe/ose drejtuar këtë grup të strukturuar dhe të organizuar kriminal (GOK) apo në mënyrë aktive ka marrë pjesë në këtë GOK, duke e ditur se pjesëmarrja e tij do të kontribuojë në kryerjen e krimeve të rënda të vrasjes së rëndë të shefit të bandës rivale [RD] (...)".

Në vijim pohohet se N.K. "ka marrë pjesë në një sërë takimesh me [ankuesin dhe persona të tjerë] në Bosnjë Hercegovinë. Pjesëmarrësit e këtyre takimeve formuan një grup kriminal të organizuar dhe të strukturuar për të planifikuar, për të bërë komplot dhe vrarë [sic] shefin e bandës rivale R.D. (...)".

Për më tepër, aktakuza iu referua dëshmisë të njërit prej dëshmitarëve, i cili pretendon se ankuesi kishte pasur arsye ta urrente viktimën pasi ky kishte qenë në marrëdhënie me gruan e ankuesit para martesës së saj. Prokurori ka kërkuar gjithashtu që ankuesi së bashku me një numër personash të tjerë të thirrej në shqyrtim gjyqësor si dëshmitar.

Ankuesi ka argumentuar se në publikimin e emrit të tij në aktakuzë, qoftë si bashkëkryerës dhe dëshmitar i dyshuar, prokurori i EULEX-it e atë dhe familjen e tij e ka ekspozuar ndaj rrezikut për jetën dhe sigurisë fizike në shkelje të neneve 2 dhe 3 të Konventa.

Ankuesi po ashtu ka pohuar se duke pretenduar publikisht që ankuesi ishte pjesë e një organizate kriminale, prokurori i EULEX-it ka shkelur nenin 6 (2) të Konventës. Ankuesi ka shtuar se, duke shkelur nenin 6 (3) të Konventës, ai nuk ishte informuar zyrtarisht rreth shkakut dhe natyrës së akuzave ndaj tij, pavarësisht se ishte efektivisht i akuzuar për vrasje. Për më tepër, ishte pohuar se ankuesi ishte përgjegjës për vrasje, mirëpo atij i ishte mohuar e drejta e vet për të pasur qasje në drejtësi, për të mbrojtur veten dhe për të ushtruar të drejtat e tij sipas nenit 6 (1) të Konventës.

Ankuesi më tej ka pohuar se veprimet e prokurorit të EULEX-it kanë përbërë shkelje të së drejtës së tij për jetën private e cila përfshinte reputacionin e tij. Në mënyrë të veçantë, ankuesi ka pohuar se aktakuza ishte e mbushur me sulme personale të rëndësisë së madhe, siç është dëmtimi i integritetit të tij personal. Prandaj EULEX-i ishte dyshuar se ka shkelur nenin 8(1) të Konventës: "Çdo njeri ka të drejtë në respektimin e jetës së tij private dhe familjare, shtëpisë dhe korrespondencës së tij".

Ankuesi më tej ka pohuar se EULEX-i ka shkelur të drejtën e tij për të marrë pjesë lirisht dhe në mënyrë të drejtë në zgjedhje demokratike duke shkatërruar dinjitetin dhe reputacionin e tij dhe rrjedhimisht karrierën e tij politike. Prandaj ankuesi është thirrur në nenet 10 dhe 11 të Konventës.

Paneli ka konstatuar se, në lëndën [2014-37, Y.B. kundër EULEX-it](#), EULEX-i Kosovë ka shkelur të drejtat e ankuesit të garantuara me nenin 8 të Konventës, përkatësisht të drejtën e tij për jetën private, e cila përfshinte reputacionin e tij. Paneli ka deklaruar se pjesa tjetër e ankesave ishte e papranueshme pasi ishin qartas të pabazuara.

Lënda nr. 2014-32, L.O. kundër EULEX-it.

Me 11 nëntor 2015, Paneli ka lëshuar vendimin në lidhje me ankesën e paraqitur nga [L.O. kundër EULEX-it Kosovë](#) dhe bëri një numër rekomandimesh për ShM në përputhje me rregullën 34 të

rregullores së punës. Kjo lëndë kishte të bënte me zhdukjen e burrit të ankueses me 24 qershor 1999. Viktima ishte mjek, i përkatësisë etnike serbe, i cili ka punuar në spitalin e Prishtinës. Ai i kishte telefonuar vajzës së tij në orën 13.00 në datë në fjalë dhe i kishte thënë se ai ishte rrugës duke ardhur nga spitali për në shtëpi. Më pas nuk kishte pasur asnjë komunikim tjetër prej tij dhe vendndodhja e mbetjeve të tij është ende e panjohur.

Paneli ka konstatuar se EULEX-i Kosovë kishte shkelur nenet 2 dhe 3 (pjesët procedurale) si dhe nenet 8 dhe 13 të Konventës dhe ndër të tjera ka bërë rekomandimet e mëposhtme për ish ShM:

- ShM-ja duhet të bëjë një deklaratë ku pranon se rrethanat e rastit kanë përbërë shkelje të të drejtave të ankueses që i atribuohen veprimeve [dhe/ose mosveprimeve] të EULEX-it në kryerjen e mandatit të tij ekzekutiv;
- ShM-ja duhet t'i udhëzoj të gjitha organet e Misionit, të cilët janë në kontakt me viktimat e supozuara të shkeljes së të drejtave ose të të afërmeve të tyre që të sigurojnë se në të gjitha komunikimet me ta të komunikojnë me masën e nevojshme të shpejtësisë, zellit dhe kujdesit të domosdoshëm për ta marrë në konsideratë traumat dhe stresin emocional të personave të tillë.
- ShM-ja duhet të siguroj që të gjitha organet hetuese në kuadër të Misionit (të TFHS dhe prokurorëve të EULEX-it) të kenë në dispozicion burimet e nevojshme dhe mbështetjen për të përmbushur misionin e tyre në mënyrë efektive dhe në përputhje me mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut të të gjithë të përfshirëve aty.
- ShM-ja duhet të kërkoj që të qartësohet marrëdhënia midis Misionit dhe TFHS-së me qëllim që të sigurohet mbrojtja efektive e të drejtave dhe të garantohet se secili organ që është në krye të çështjes ofron informacionin e duhur dhe të mjaftueshëm për ankuesit.

ShM ka deklaruar në një letër të datës 29 prill 2016, si përgjigje ndaj rekomandimeve të Panelit: “Pasi që rekomandimet e Panelit kanë të bëjnë me masat që janë në dispozicion të Planifikimit Civil dhe Aftësive të Udhëheqjes, disa institucione të BE-së, si dhe shtetet anëtare, kam informuar PCAU dhe shtetet kontribuuese rreth vendimit dhe gjetjeve të Panelit, nëpërmjet komandantit të Operacioneve Civile dhe prandaj e konsideroj që rekomandimi është zbatuar.”

Në vlerësimin e tij për zbatimin e rekomandimeve nga ana e ish-ShM, Paneli ka vërejtur se përgjegjësia për zbatimin e rekomandimeve të Panelit bie tërësisht dhe ekskluzivisht mbi ShM, e jo mbi PCAU e as mbi shtetet anëtare.

Së dyti, është vërejtur se përgjigja nuk ka treguar se çfarë përpjekje, nëse ka, ishte bërë në mënyrë që të zbatohen rekomandimet e Panelit.

Në fund dhe në kundërshtim me supozimin e bërë në përgjigjen e ShM, përgjegjësia për të vendosur nëse rekomandimet e Panelit janë zbatuar apo jo i takon tërësisht Panelit.

Në këtë drejtim Paneli ka theksuar se përderisa rekomandimet e tij nuk janë ligjërish të detyrueshme, është thelbësore për legjitimitetin dhe kredibilitetin e EULEX-it, si mision i sundimit të ligjit, që me vendosmëri dhe me kredibilitet të demonstrojë angazhimin e vet për zbatimin efektiv të të drejtave të njeriut duke u siguruar që veprimet e tij të jenë në çdo kohë në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Kështu Paneli ka deklaruar njëzëri se ish ShM nuk i ka zbatuar rekomandimet e tij dhe ka ftuar ShM të ri që t'i shqyrtoj plotësisht dhe ta zbatoj secilin prej rekomandimeve dhe duhet të informojë

Panelin rreth veprimeve të ndërmarra në këtë drejtim. Së fundi Paneli ka deklaruar se e ka të hapur këtë çështje.

Gjithashtu në këtë pikë kjo duhet të pranohet se pavarësisht lëndës së mësipërme L.O., Paneli është shumë i kënaqur me mënyrën në të cilën ShM të njëpasnjëshëm kanë zbatuar deri më tani rekomandimet e Panelit.

Znj. Magda Mierzevska, kryesuese e Panelit ka marrë pjesë në diskutimet e Panelit përmes komunikimeve elektronike, në përputhje me dispozitat e nenit 13 (3) të rregullores së punës së Panelit.

Takimet me Shërbimin Evropian për Veprim të Jashtëm (EEAS) dhe Komisionin për Aspektet Civile të Menaxhimit të Krizave, (CivCom) Bruksel.

Paneli i përfaqësuar nga kryesuesja znj Magda Mierzevska dhe zyrtari i lartë ligjor John J Ryan ka marrë pjesë në një sërë takimesh me znj. Jana Kaliminova, kryesuese e CivCom; z. Bert Vermessen, zëvendëskomandant i Operacioneve civile dhe shefi i stafit, Planifikimit Civil dhe Aftësive të Udhëheqjes, (CPCC), EEAS, z. Alexis Hupin, zyrtar i ngarkuar për Kosovë, Shërbimi Evropian për Veprim të Jashtëm të Bashkimit Evropian, (EEAS); si dhe përfaqësuesin e shteteve anëtare të Grupit Punues CivCom, në Bruksel, me 28 shtator 2016.

Rendi i ditës së takimit ka përfshirë diskutime ndër të tjera rreth zbatimit të rekomandimeve të Panelit nga shefi i Misionit; kompensimin dhe korigjimin për viktimat; përputhja me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, Rregullorja e Punës së Panelit dhe procedurat pasuese; trajnimi hyrës, mësimet e nxjerra dhe trashëgimia e Panelit. Kryesuesja e Panelit po ashtu ka informuar përfaqësuesit e vendeve anëtare të CivCom-it rreth Panelit dhe pastaj është pasuar me pyetje e përgjigje.

Takimi me shefin e Misionit të EULEX-it Kosovë

Paneli është takuar me znj. Alexandra Papadopoulou, shefe e re e Misionit, e shoqëruar nga znj. Elaine A Paplos, znj. Marianne Fennema dhe znj. Heidi Lempio në zyrat e PShDNj-së me 17 tetor 2016.

Çështjet e diskutuara ishin sfida sa i përket personelit në Sekretariat pas procesit të rikonfigurimit të EULEX-it Kosovë, numri i lëndëve të Panelit, zbatimi i vendimeve të Panelit nga shefja e Misionit, trashëgiminë e ardhshme e EULEX-it, si dhe trashëgimia e Paneli. Në përfundim ShM ka thënë se ajo do t'i mirëprit mundësitë e ardhshme për t'u takuar me Panelin.



Nga e majta: Heidi Lempio, Alexandra Papadopoulou, Elaine A Paplos, John J Ryan, Elka Ermenkova dhe Guenael Mettraux

Takimi me përfaqësuesin Special të Bashkimit Evropian në Kosovë

Paneli po ashtu është takuar me znj. Nataliya Apostolova, përfaqësuese speciale e Bashkimit Evropian, e cila ishte e shoqëruar nga Shaban Murturi, në ndërtesën e PSBE-së, rruga Kosova nr.1, Prishtinë, me 17 tetor 2016.

Çështjet që janë ngritur për diskutim janë si në vijim: zbatimi i rekomandimeve të Panelit nga EULEX-i, numri i lëndëve të Panelit dhe natyra e ankesave që janë parashtruar në Panelit, nevoja për një mekanizëm llogaridhënës për të drejtat e njeriut në misionet ekzekutive të Politikës së Sigurisë dhe Mbrojtjes së Përbashkët si dhe trashëgimitë të EULEX-it Kosovë dhe Panelit.

Në përfundim PSBE ka thënë se ajo do t'i mirëpret takimet e tilla të ardhshme me Panelin.



Nga e majta: Elka Ermenkova, Guenael Mettraux, John J Ryan, Shaban Murturi dhe Nataliya Apostolova

Burimet njerëzore

Znj. Katja Dominik, anëtare e Panelit nga EULEX-i Kosovë dhe gjykatëse penale në Gjykatën Themelore në Mitrovicë ka dhënë dorëheqje si anëtare e Panelit nga EULEX-i Kosovë me 14 qershor 2016 në mënyrë që të përqendrohen në përgjegjësitë e veta gjyqësore në rritje në Gjykatën Themelore në Mitrovicë.

Znj. Elka Ermenkova, gjykatëse penal e Gjykatës Supreme/Gjykatës së Apelit në Prishtinë dhe anëtare zëvendësuese e EULEX-it Kosovë në Panel ishte emëruar anëtare e rregullt e EULEX-it Kosovë në Panel me 14 tetor 2016.

Znj. Anna Bednarek, gjykatëse e Apelit, Kolegji i ankesave i Agjencinë Kosovare të Pronës, Prishtinë është emëruar anëtare zëvendësuese e EULEX-it Kosovë në Panel me 14 tetor 2016.

Znj. Magda Mierzewska, kryesuese e Panelit shfrytëzon rastin të falënderoj znj. Dominik për kontributin e saj të dalluar profesional në punën e Panelit gjatë katër (4) viteve të saj të shërbimit të përkushtuar dhe t'i dëshiroj asaj suksese në detyrën e saj të tanishme dhe në karrierën e mëtejshme.

Po ashtu znj. Mierzewska shfrytëzon rastin të uroj znj. Ermenkova në emërimin e saj të fundit si anëtare e re e EULEX-it Kosovë në Panel.

Më tutje ajo uron znj. Bednarek për emërimin e saj si anëtare zëvendësuese e EULEX-it Kosovë në Panel dhe e mirëpret atë përsëri në Panel në cilësinë e anëtares zëvendësuese.

Zyrtarët ligjorë: Paul Landers dhe Joanna Marszalik kanë përfunduar kontratën me Panelin me 16 gusht dhe 31 gusht. Znj. Magda Mierzewska në emër të Panelit do të donte të shprehte mirënjohjen e saj për të dytë nga ta për kontributin e tyre të shkëlqyer në punën e Panelit dhe t'ju uroj atyre suksese të vazhdueshëm në karrierën e tyre profesionale.


Znj. Mierzewska gjithashtu shfrytëzon këtë rast të shpreh mirënjohjen për znj. Shpresa Gosalci, asistente administrative/asistente gjuhësore për kontributin e saj të shkëlqyer në punën e Panelit gjatë gjashtë (6) viteve të fundit. Znj. Gosalci ka përfunduar kontratën me Panelin me 14 nëntor.

Më tej ajo shfrytëzon rastin t'i uroj mirëseardhje zyrtares së re ligjore, Noora Aarnio, zyrtare ligjore, Gjykata e Apelit, Gjykata Supreme, në emërimin e saj të ri në Panel dhe t'i uroj asaj suksese në detyrën e saj të re.

Më në fund rreth çështjes së personelit mund të theksohet se Paneli është dashur të funksiononte me shërbimet e vetëm një (1) zyrtari ligjor që prej largimit të dy (2) zyrtarëve të tjerë ligjorë me 16 gusht dhe 30 shtator siç përshkruhet më lartë.

Statistikat e lëndëve

Ka pasur një rritje të konsiderueshme të numrit të lëndëve të Panelit deri më tani këtë vit, ku janë regjistruar tridhjetë e katër (34) ankesa të reja. Paneli ka shqyrtuar rreth njëzet e dy (22) lëndë deri më tani gjatë këtij viti dhe ka konstatuar se EULEX-i Kosovë ka bërë nëntë (9) shkelje të të drejtave të njeriut. Aktualisht janë pesëdhjetë e shtatë (57) lëndë të pazgjidhura në Panel.



Seanca e radhës së Panelit

Seanca e radhës së Panelit është caktuar të mbahet nga data 9 deri me 11 janar 2017.

Vizitoni faqen tonë të internetit: www.hrrp.eu



SI TË PARASHTROHET ANKESA NË PSHDNJ

(Rregullat 25 dhe 26 të rregullores së punës të PShDNj-së)

Kush?

Çdo person i cili nuk punon për misionin e EULEX-it në Kosovë, i cili ankohet se ka qenë viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut nga ana e misionit të EULEX-it në Kosovë gjatë zbatimit të mandatit ekzekutiv të tij.

Ankuesi (personi që e bën ankesën) mund të përfaqësohet nga ndonjë avokat ose përfaqësues tjetër sipas dëshirës së tij ose saj. Në këtë rast duhet të plotësohet autorizimi.

Çka?

Paneli do t'i shqyrtojë vetëm ato ankesa që kanë të bëjnë me këto shkelje të dyshuara, të cilat kanë ndodhur në Kosovë pas datës 9 dhjetor 2008. Shkelja duhet të jetë shkaktuar nga misioni i EULEX-it në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit ekzekutiv të tij.

Paneli nuk do t'i shqyrtojë procedurat gjyqësore të kryera nga gjykatat në Kosovë.

Kur?

Ankesa duhet t'i parashtrohet Panelit brenda gjashtë muajve nga data e shkeljes së dyshuar.

Si?

Ankesa duhet të parashtrohet me shkrim. Ankesa nuk mund të bëhet me telefon. Ankuesi mund ta përdorë gjuhën angleze, shqipe ose serbe. Normalisht, ankesa duhet të plotësohet në formularin përkatës dhe të shoqërohet me dokumente dhe vendime përkatëse (nëse ka), sipas udhëzimeve në formular.

Nëse ankesa paraqitet me anë të letrës, në të duhet të përcaktohet, të paktën në formë të përmbledhur, lënda e ankesës në mënyrë që ajo të shqyrtohet më tej.

Ku?

Ankesa mund të parashtrohet në:

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut - sekretariati

Rr. Rrustem Statovci nr. 29 – 10000 Prishtinë – Kosovë

Tel: +381 (0) 38 78 2125

Ankesa gjithashtu mund të parashtrohet përmes postës elektronike në: office@hrrp.eu

www.hrrp.eu

Plotësimi i formularit për ankesë

Ankesa duhet të shkruhet qartë dhe lexueshëm, dhe mundësisht të jetë e shtypur me kompjuter.

Formulari duhet t'i përfshijë të gjitha hollësitë kontaktuese të ankuesit.

Nëse ankesa përmban fakte të dokumentuara, duhet të paraqiten kopjet e lexueshme. **Mos i dërgoni dokumentet origjinale.**

Dokumentet duhet të renditen sipas datës dhe të shënohen me numra rendor të njëpasnjëshëm dhe me një përshkrim të shkurtë (p.sh. letër, urdhër, vendim, ankesë, etj.).

Ankesës i caktohet numri i dosjes. Numri i dosjes duhet të përmendet në të gjitha korrespondencat vijuese. Nëse ankuesi tashmë e ka një ankesë, e cila është duke u shqyrtuar nga Paneli, ai/ajo duhet ta informojë Panelin lidhur me numrin e dosjes së mëparshme. Nëse ankuesi për arsye të ndryshme nuk dëshiron që identiteti i tij/saj të bëhet publik, ai/ajo duhet ta plotësojë pjesën përkatëse në formularin e ankesës.